



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:040763

Datë: 30.07.2024

Numri i dokumentit: 05999258

KPPP.nr.244/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Capital - Invest” SH.P.K., me NUI: 810187428, me seli në Prishtinë, rruga “Uran Ajeti” nr.3-4, përfaqësuar sipas autorizimit nga Besnik Kuçi, avokat nga Suhareka, kundër debitorit “Bau Fix” SH.P.K., me NUI: 811286831, me seli në Suharekë, Magjistratja Suharekë - Rahovec, përfaqësuar sipas autorizimit nga Zahir Hamza, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.13/2024 të datës 05.01.2024, të Përmbartuesit Privat Liridon H. Tërshani, me seli në Prizren, jashtë seancës me datës 30.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Bau Fix” SH.P.K., i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.13/2024 të datës 05.01.2024, të Përmbartuesit Privat Liridon H. Tërshani.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.13/2024 i datës 05.01.2024, i Përmbartuesit Privat Liridon H. Tërshani.
- III. URDHËROHET debitori “Bau Fix” SH.P.K., që në rast të parashtrimit ankesës, të deponoj në llogari të veçantë të “Këshillit Gjyqësor të Kosovës” nëpërmjet arkës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, garancionin në shumën prej 13,400.00 € (trembëdhjetë mijë e katërqind euro), në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

- IV. Nëse debitori nuk e deponon garancionin brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.
- V. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t'ia paguaj kreditorit shumën prej 208.00 € (dyqind e tetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Capital - Invest” SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.13/2024 të datës 05.01.2024, me të cilin e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. 23-SHV01-001-479 të datës 25.10.2023, me të cilin ka detyruar debitorin që pas pranimit të këtij urdhri kreditorit t'ia paguaj borxhin në shumën prej 13,400.00 €, me kamat ligjore 8% në vit nga dita kur është bërë kërkesa e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore dhe ato të përfaqësimit, ashtu që të bllokohen të gjitha llogaritë bankare pranë të gjitha bankave, po ashtu dhe me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorit deri në arritjen e borxhit në tërësi si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se urdhri përmbarimor përmban të meta i njëjti është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së. Tutje ka shtuar se propozimi për përmbarim nuk përmban asnjë nga provat të mbështetura në propozim por vetëm numrat, pra në rastin konkret kemi të bëjmë me debitor i cili ushtron veprimtari ekonomike, procesverbalet e veprimeve të kreditorit nuk janë dokumente të përmbarueshëm, andaj pretendimet e paraqitura nga ana e kreditorit nga propozimi për përmbarim nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në procedurë përmbarimore por të njëjtat mund të jenë objekt shqyrtimi në procedurë kontestimore. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ta anuloj urdhrin përmbarimor si dhe të obligohet kreditori që debitorit t'ia kompensoj shpenzimet e përpilimit të prapësimin në shumë prej 154.00 €.

Kreditori përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se kreditori propozimit për përmbarim nuk i ka bashkangjitur faturën e

cila është objekt i kësaj procedure përbarimore pasi që kreditori propozimit për përbarim i ka bashkangjitur faturën në origjinal. Tutje ka shtuar se fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori përmes Email si dhe SMS të pronarit, e njëjta nuk është kundërshtuar asnjëherë, mirëpo është konfirmuar pranimi i saj me pagesën e pjesshme që i është bërë kreditorit në shumën prej 10,000.00 €. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ta lë në fuqi urdhrin përbarimor si dhe të obligohet debitori që kreditorit t'ia kompensoj shpenzimet e përpilimit të përgjigjes në prapësim në shumën prej 416.00 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të cilës është lejuar urdhri për përbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Faturën Nr. 23-SHV01-001-479 të datës 25.10.2023, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara

mallrat të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, Gjykata ka vërtetuar faktin që kreditori me datën 26.10.2023, ka paguar shumën në vlerën prej 10,000.00 € për obligimin që ka rrjedhur nga Fatura Nr. 23-SHV01-001-479 e datës 25.10.2023, sipas transaksionit bankar e cila evidentohet me nr. Transaksioni 77801265687000.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura, i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, përmban pagesë të realizuar në emër të kësaj fature si dhe nuk është kontestuar asnjëherë nga debitori

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e tjera të debitorit në këtë procedurë, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbartimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbartimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Në pikën IV të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin, në rast të parashtrimit të ankesës të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar si në këtë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbartimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i' a njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë në

shumën prej 208.00 €, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.244/24, datë 30.07.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.